



Vertical Forest Tirana



Immagini



Tirana Riverside Albania



Immagini




Tirana 2030 Albania



immagini



video



Immagini



Progetto

Stefano Boeri Architetti

Luogo

Tirana, Albania



Immagini



Progetto

Stefano Boeri Architetti

Cliente

Invest society

Tipologia

Architettura

Credits

luogo

Tirana, Albania

Anno

2017 - 2025

Situato nel centrale quartiere di **Blloku** a **Tirana** nelle immediate vicinanze del palazzo della Presidenza del Governo albanese, il progetto di **West Residences** occupa un lotto stretto e lungo e si attesta su un asse viario importante con la sua facciata più corta aprendosi invece con la facciata più estesa su un ampio spazio pubblico all'interno del tessuto urbano che lo mette direttamente in relazione con altri edifici pubblici presenti nella zona.

Il volume può essere letto come una composizione di cubi sovrapposti, una serie di moduli residenziali autonomi leggermente sfalsati in modo da dotare ogni unità abitativa di almeno una loggia o un balcone. Questa soluzione a livello architettonico permette di avere diversi spazi vivibili per ognuno dei trenta appartamenti in cui si articola l'edificio.

VENDIM

Nr. 5800/4, datë 2.8 2023

“PËR SHPALLJEN E RENDITJES FINALE TË STUDIOVE KONKURUESE NË KONKURSION NDËRKOMBËTAR PËR NËN NJËSINË G10, TË NJËSISË STRUKTURE TR/456, MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR. 5, DATË 26.07.2018 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR ZONËN E BULEVARDIT, PARKUT QËNDROR DHE LUMIT TË TIRANËS, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b), nenin 23, pika 14 dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; vendimit nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar; vendimit nr. Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”; vendimit nr.1, datë 14.4.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tiranë” të ndryshuar; Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5, datë 26.07.2018 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për zonën e bulevardit, parkut qendror dhe lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 4 datë 10.02.2022 për “Konkurset ndërkombëtare për zhvillimin e territorit për zonën e bulevardit, parkut qendror dhe lumit të Tiranë”; urdhëresës nr. 24641, datë 04.07.2022 “Për organizimin e konkurseve ndërkombëtare për zhvillimin e territorit të njësisë strukturore TR/456, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5, datë 26.07.2018 “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për zonën e bulevardit, parkut qendror dhe lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë”; Urdhërit nr. 38060, datë 28.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik si strukturë mbështetëse të jurisë për vlerësimin e konkurseve ndërkombëtare në njësinë strukturore TR/456, Bashkia Tiranë”; kërkesës me nr. prot. A-24445, datë 21.10.2022 për shprehje interesi për zhvillimin e konkursit për nën njësinë G10, të njësisë strukturore TR/456; Vendimit nr. 38905, datë 03.11.2022 “Për shpalljen e konkursit ndërkombëtar për nën njësinë G10, të njësisë strukturore TR/456, Bashkia Tiranë”; urdhërit nr. 38905/1, datë 03.11.2022 “Për miratimin e Jurisë për vlerësimin e konkurseve ndërkombëtare për nën njësinë G10, të njësisë strukturore TR/456, Bashkia Tiranë”; Vendimit të Kryetarit me nr. Prot. 1828/2, datë 20.02.2023, shkresës me nr. Prot. 5808/1, datë 24.04.2023 “Kërkesë për plotësime të projekteve të prezantuara”, shkresës me nr. Prot. 5808/2, datë 22.05.2023 nga shoqëria “SON Engineering & Construction” sh.p.k. dhe shkresës me 5808/3, datë 05.06.2023 nga Sekretariati Teknik si strukturë mbështetëse të jurisë për vlerësimin e konkurseve ndërkombëtare në njësinë strukturore TR/456, Bashkia Tiranë,

VENDOSA:

1. Të miratojë shpalljen e renditjes finale të konkursit ndërkombëtar për nën njësinë G10, të njësisë strukturore TR/456, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5, datë 26.07.2018 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për zonën e bulevardit, parkut qendror

dhe lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë, bazuar në procesverbalin sipas sistemit të pikëzimit dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, si më poshtë:

- Bashkimi i operatorëve shoqëria “SON Engineering & Construction” sh.p.k. dhe shoqëria “STEFANO BOERI ARCHITETTI” s.r.l. dhe shoqëria “STEFANO BOERI ARCHITETTI” sh.p.k.
RENDITET I PARI, ME **95 PIKË**
 - Bashkimi i operatorëve “Sokol Imeraj” – Person fizik (emri tregtar Studio City Project) dhe Alessandro Iezzi (emri tregtar K3M Architects)
RENDITET I DYTË, ME **40 PIKË**
2. Bashkimi i operatorëve shoqëria “SON Engineering & Construction” sh.p.k. dhe shoqëria “STEFANO BOERI ARCHITETTI” s.r.l. dhe shoqëria “STEFANO BOERI ARCHITETTI” sh.p.k., i renditur i pari, konsiderohet studio fituese dhe projekti i paraqitur do t’i nënshkrohet procesit të realizimit të projektit të zbatimit dhe procedurave të mëtejshme për pajisje me leje ndërtimit sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Bashkinë e Tiranës.
 4. Vendimi për shpalljen e renditjes finale dhe procesverbali me sistemin e pikëzimit bashkëlidhur këtij vendimi botohet në mjete tradicionale të informimit me publikun dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

JURIA E KONKURSIT:

Erion Velaj
Arbjan Mazniku
Frida Pashako
Ledia Tota
Luan Leka
Andrea Maliqari
Ardian Asllani



PROCES VERBAL SIPAS SISTEMIT TË PIKËZIMIT¹

Sot më datë 27.01 2023, u mbledh Juria e konkursit dhe vlerësoi operatorët pjesmarrës sipas kritereve të vlerësimit të parcaftuar në detyrën e projektimit, si më poshtë:

K1: Krijimtaria hapsinore (0-20 pikë), përfshin: Konceptin hapsinor të zgjidhjes; Cilësinë e hapsirës; Paraqitjen grafike teknike të projektit

K2: Përshatshmëria e propozimit me funksionin e kërkuar (0-30 pikë), përfshin: Funksionalitetin e zgjidhjes; Shfrytëzimin racional të hapsirës; Fleksibilitetin e hapsirës; respektimin dhe përmbushjen e detyrës së projektimit dhe programit hapsinor.

K3: Kriteri ekonomik (0-20 pikë), përfshin: Faktori i lartë i zbatueshmërisë së idesë së projektimit; Mirëmbajtjen dhe shpenzimet; Racionaliteti inxhinierik.

K4: Kriteri estetik (0-15 pikë), përfshin: Lidhjen dhe impaktin e propozimit me kontekstin; Originalitetin e zgjidhjes; Inovacionin dhe vlerat estetike.

K5: Kriteri ekologjik – arkitekturë e qëndrueshme (0-15 pikë), përfshin: Efiçencën energjetike.

Nr.		Bashkimi i operatorëve Alessandro Iezzi (emri tregtar K3M Architects) dhe "Sokol Imeraj" (emri tregtar Studio City Project)					Bashkimi i operatorëve: shoqëria "STEFANO BOERI ARCHITETTI" s.r.l.; shoqëria "SON Engineering & Construction" sh.p.k.; shoqëria "STEFANO BOERI ARCHITETTI" sh.p.k.					nënshkrimi
		K1	K2	K3	K4	K5	K1	K2	K3	K4	K5	
1.	Erion VELIAJ	10	15	5	5	5	20	30	20	15	15	
2.	Arbjan MAZNIKU	10	15	5	5	5	20	30	20	15	15	
3.	Frida PASHAKO	10	15	5	6	6	18	25	20	13	14	
4.	Ledia TOTA	5	15	10	5	10	17	25	20	13	14	
5.	Luan LEKA	10	15	5	5	5	22	30	18	15	15	
6.	Andrea MALIQARI	5	10	10	5	5	18	30	20	15	12	
7.	Ardian ASLLANI	10	8	10	5	5	20	30	15	15	13	
	TOTALI I PONDERUAR	40					95					

Ky proces verbal mbahet në tre kopje dhe i bashkëlidhet vendimit për shpalljen e renditjes finale të operatorëve pjesmarrës.

¹ Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e projekt ideve duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Pikët maksimale që mund të marrë një projekt do të jenë 100.

BASHKIA E TIRANËS

1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia e Tiranës Adresa Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi Postar 1001

Tel/Fax 00 355 4 22 56 799E-mail prokurimet@tirana.gov.alFaqja e Internetit www.tirana.gov.al

2.Lloji i procedurës: "Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontrates me rrugë shkresore", NË MBËSHTETJE TË AKTIT NORMATIV NR. 9, DATË 16.12.2019 "PËR PËRBALLIMIN E PASOJAVE TË FATKEQËSISË NATYRORE"; NENI 44 "Për nevoja emergjente në verifikimin e dëmeve, lidhjen e kontratave të konsulencës, blerjen e pajisjeve të rëndësishme parësore për gjendjen e krijuar dhe përjashtimisht në rastet e pamundësisë së përdorimit të procedurave të parashikuara në këtë ligj, me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore autoritetet përgjegjëse shtetërore përdorin procedurën e prokurimit me negocim pa shpallje sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Procedura e prokurimit publik në këtë rast zhvillohet në formë shkresore."

3.Objekti i kontratës Për Lotin I "Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona "5 maji", Bashkia Tiranë

4. Fondi limit: 5,658,170 (pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH.

5. Vlera totale përfundimtare e kontrates: 6.739.800 (gjashtë milion e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë me TVSH

6. Data e lidhjes së kontratës : 06.03.2020

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 225/290

Buletini Nr. 20 datë 21 Prill 2020

Agjencia e Prokurimit Publik

7.Emri dhe NIPTI i kontraktorit: Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "Stefano Boeri Architetti SRL" & "Son Engineering & Construction" Shpk

NIPTI 07526210963 & L51424014F

Adresa: TIRANE Rruga "Ali Spahia", Nr.3.

Adresa: Seli qendrore Në Milano, Via G.Donizetti, Nr 4, Italy .